



Udhëzuesi i Atletit për  
Ndryshimet e Rëndësishme  
në Kodin 2021



**ADEL**



# Tabela e Përmbajtjes

Cili është qëllimi i këtij Udhëzuesi të Atletit për Kodin 2021?	<b>4</b>
Çfarë është Kodi Botëror Anti-Doping?	<b>4</b>
Cilat janë Standardet Ndërkombëtare?	<b>5</b>
Kur hyn në fuqi Kodi i ri?	<b>6</b>
Çfarë po bëjnë Organizatat Anti-Doping për t'u përgatitur për Kodin 2021?	<b>7</b>
Në cilën kategori atletësh bëni pjesë?	<b>7</b>
Çfarë ndryshimesh janë bërë në arsyetimin e Kodit?	<b>8</b>
Ju rikujtojmë: Rolet dhe përgjegjësitë tuaja në Kodin 2021	<b>11</b>
Përkufizimet - Cilat janë risitë në Kodin 2021?	<b>12</b>
Cilat janë risitë në edukim?	<b>13</b>
Çfarë është e rëndësishme për atletët e tërhequr që rikthehen në garë?	<b>14</b>
Çfarë ndryshimesh janë bërë në grupet specifike të atletëve?	<b>15</b>
Çfarë ka ndryshuar tek substancat dhe si zbulohen ato?	<b>16</b>
Çfarë ka ndryshuar në mënyrën se si mund përdoren të dhënat dhe mostrat?	<b>18</b>
Çfarë ka ndryshuar në mënyrën se si menaxhohen rezultatet?	<b>19</b>
Çfarë ndryshimesh janë bërë në shkeljet e rregullave anti-doping (ADRV) dhe sanksionet?	<b>20</b>
Ndryshimet	<b>22</b>
Cilat janë risitë lidhur me seancën dëgjimore dhe ankimin?	<b>25</b>
Konkluzion	<b>26</b>

## Cili është qëllimi i këtij Udhëzuesi të Atletit për Kodin 2021?

Qëllimi ynë është t'ju ndihmojmë të kuptoni ndryshimet kryesore në Kodin Botëror Anti-Doping (Kodi), veçanërisht ato që kanë ndikimin më të madh tek ju. Mbrojtja e shëndetit tuaj dhe të drejtat tuaja anti-doping janë në qendër të përpjekjeve tona në mbrojtjen e sportit të pastër. Ndërsa asgjë nuk zëvendëson fjalët aktuale të Kodit ose të rregullave anti-doping të Organizatës suaj Anti-Doping (OKAD) (dokumentet ligjërish të detyrueshme), ky udhëzues synon t'ju japë një përmbledhje të thjeshtuar të asaj që vjen në 2021.

### Çfarë është një Nënshkrues i Kodit?

*Organizatat që kanë pranuar ose nënshkruar Kodin Botëror Anti-Doping quhen Nënshkruese. Disa organizata duhej të bëheshin Nënshkruese për të marrë pjesë në aktivitetet të tilla si Lojërat Olimpike dhe Paralimpike. Organizata të tjera kanë zgjedhur të bëhen një Nënshkrues i Kodit për të mbrojtur më tej të drejtat e atletëve të tyre për një sport të pastër.*

*Nënshkruesit e Kodit duhet të jenë në përputhje me Kodin dhe Standardet Ndërkombëtare.*

## Çfarë është Kodi Botëror Anti-Doping?

Kodi Botëror Anti-Doping (Kodi) përcakton rregullat anti-doping për të gjitha sportet dhe të gjitha vendet. Kodi mbron të drejtën tuaj themelore, si një atlet, për të marrë pjesë në një sport të pastër. Kodi promovon dhe mbron shëndetin, drejtësinë dhe mundësitë e barabarta për ju dhe atletët në të gjithë botën.

Kodi për herë të parë hyri në fuqi në korrik 2004. Kodi 2021, i cili do të hyjë në fuqi më 1 janar 2021, është versioni i katërt.

Kodi është pranuar nga e gjithë Lëvizja Olimpike si dhe nga organizma të ndryshme sportive dhe Organizata Kombëtare Anti-Doping (NADO) në të gjithë botën. Ai është njohur gjithashtu nga më shumë se 185 qeveri, përmes Konventës së UNESCO-s kundër Dopingut në Sport. Të dy palët, qeveritë dhe organet e sportit janë të përkushtuar për një sport të pastër!

Me qëllim zbatimin e Kodit, secili Nënshkrues ka një program anti-doping me rregulla anti-doping që merr parasysh realitetet e vendit dhe sportit të tyre. Këto rregulla duhet të jenë në përputhje me Kodin dhe WADA duhet t'i miratojë ato. Është e rëndësishme që ju të jeni të vetëdijshëm për rregullat që zbatohen për ju.

*Kodin mund ta gjeni në faqen e internetit të Agjencisë Botërore Anti-Doping (WADA).*

[www.wada-ama.org](http://www.wada-ama.org)

# Cilat janë standardet ndërkombëtare?

Agjencia Botërore Anti-Doping (WADA), në konsultim me komunitetin anti-doping dhe atletët, ka hartuar Standarde Ndërkombëtare për fusha të ndryshme teknike të anti-dopingut për të siguruar që ka qëndrueshmëri në të gjithë botën. Zbatimi i Standardeve Ndërkombëtare është i detyrueshëm për të gjithë Nënshkruesit e Kodit.

- **Standardi Ndërkombëtar për Edukimin (ISE)** është një Standard i ri në 2021) - siguron që të gjitha Organizatat Anti-Doping (ADO) zbatojnë programe të edukimit anti-doping për atletët dhe personelin mbështetës të atletit, që ata të jenë të vetëdijshëm për gjithshka që i përket luftës kundër dopingut dhe vlerat e sportit të pastër. Një parim kryesor i Standardit Ndërkombëtar është rëndësia që atletët të edukohen para se të testohen.



*Personeli mbështetës i atletit është çdo trajner, instruktor, menaxher, agjent, staf i ekipit, zyrtar, personel mjekësor, ndihmës mjekësor, prind ose ndonjë Person tjetër që punon me të, duke trajtuar ose ndihmuar një atlet që merr pjesë ose përgatitet për konkurim.*

- **Standardi Ndërkombëtar për Listën e Ndaluar (Lista)** - kjo është lista e substancave dhe metodave që janë të ndaluara. Ju duhet të njiheni me Listën dhe kur substancat janë të ndaluara (vetëm në garë ose në çdo kohë). Sigurohuni që personeli juaj mbështetës të jetë në dijeni të Listës. Asnjëherë mos merrni ndonjë substancë ose përdorni ndonjë metodë përpara se të konsultoheni me Listën.
- **Standardi Ndërkombëtar për Përrjashtimet e Përdorimit Terapeutik (ISTUE)** - përshkruan procesin që atletët të aplikojnë për Përrjashtimin e Përdorimit Terapeutik (TUE), i cili mund t'i lejojë ata të përdorin një substancë ose metodë të ndaluar për të trajtuar një gjendje të ligjshme mjekësore.



*Nëse keni nevojë për një TUE, duhet të aplikoni vetëm në një organizatë - kontrolloni me Federatën tuaj Ndërkombëtare (IF) ose Organizatën tuaj Kombëtare Anti-Doping (NADO). Ju nuk mund të keni një TUE nga më shumë se një Organizatë Antidoping për të njëjtën gjendje.*

*NADO miraton TUE për atletët e nivelit kombëtar. Këto janë të vlefshme në çdo aktivitet të nivelit kombëtar, në çdo shtetë.*

*Federatat Ndërkombëtare (IF) miratojnë TUE për atletët e nivelit ndërkombëtar. Këto janë të vlefshme në çdo nivel ndërkombëtar.*

- **Standardi Ndërkombëtar për Testimin dhe Hetimet (ISTI)** - përshkruan se si testimi dhe hetimet anti-doping duhet të kryhen nga ADO-t, përfshirë Pasaportën Biologjike të Sportistit (ABP). Ndryshimet e fundit në ISTI përfshijnë:
  - Alkooli nuk lejohet më në stacionin e kontrollit doping;
  - Densiteti specifik i pranueshëm në një mostër urine u ndryshua në vitin 2020;
  - Zyrtari i kontrollit doping do të ruajë tani në mënyrë të sigurt mostrën tuaj të pjesshme.

- **Standardi Ndërkombëtar për Laboratorët (ISL)** - përcakton se si analizohen mostrat e kontrollit doping të urinës dhe gjakut dhe si duhet të trajtohen të dhënat në lidhje me mostrat. Vetëm laboratorët që janë akredituar nga WADA mund të analizojnë mostrat për qëllime të kontrollit doping. Laboratorët duhet të ndjekin standarde të rrepta për t'u akredituar dhe për të mbajtur akreditimin e tyre. ISL gjithashtu thekson se si programet e testimit të tilla si ABP duhet të menaxhohen nga laboratorët.

*Pasaporta Biologjike e Atletit (APB) monitoron variablat e zgjedhura të gjakut (biomarkuesit e dopingut) të një atleti individual me kalimin e kohës.*

i

*Kjo do të thotë se kërkohet për ndryshime në profilin e gjakut të një individi që mund të dëshmojë dopingun sesa të zbulojnë një substancë specifike.*

- **Standardi Ndërkombëtar për Menaxhimin e Rezultateve (ISRM)** (i ri në 2021) - siguron që të gjitha shkeljet e rregullave anti-doping (ADVR) përfshirë procesin e dëgjimit trajtohen në mënyrë të vazhdueshme dhe të drejtë.
- **Standardi Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Informacionit Personal (ISPPPI)** - përshkruan parimet që ADO-t duhet të respektojnë për të siguruar privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave tuaja kur ata mbledhin, menaxhojnë, përpunojnë dhe ruajnë të dhëna personale për qëllime anti-doping.
- **Standardi Ndërkombëtar për Pajtueshmërinë e Kodit nga Nënshkruesit (ISCCS)** - siguron që rregullat dhe programet anti-doping në përputhje me Kodin të zbatohen dhe aplikohen në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha sportet dhe të gjitha vendet. Kjo ju ndihmon të keni besim në programin global anti-doping dhe në përpjekjet tona për të mbrojtur integritetin e garës sportive. ISCCS lejon që WADA të monitorojë pajtueshmërinë e Nënshkruesve me Kodin dhe të marrë masa kundër atyre që nuk janë në përputhje.

## Kur hyn në fuqi Kodi i ri ?

Kodi Botëror Anti-Doping 2021 (Kodi) u miratua në Nëntor 2019 në Konferencën Botërore të Dopingut në Sport. Ndryshimet në Kod hyjnë në fuqi në 1 janar 2021.



# Çfarë po bëjnë Organizatat Anti- Doping për t'u përgatitur për Kodin 2021?

Nënshkruesit e Kodit Botëror Anti-Doping (Kodi) Nënshkruesit duhet të ndryshojnë rregullat dhe programet e tyre anti-doping për të qenë në përputhje me Kodin 2021 deri më 1 janar 2021. Është e rëndësishme të kontrolloni faqen e internetit të Organizatës tuaj Anti-Doping (ADO) për të marrë një kopje vend rregullave të reja anti-doping. Çdo ndryshim në rregullat dhe procedurat anti-doping duhet të vihet në dispozicion.

WADA po ndihmon ADO-t të përgatiten për Kodin 2021 përmes Programit të Ndhmës për Zbatimin e Kodit (CISP). Mund të mësoni më shumë në ADEL [<https://adel.wada-ama.org>].

## Në cilën kategori atletësh bëni pjesë?

Kodi Botëror Anti-Doping (Kodi) përcakton disa nivele ose kategori të ndryshme të atletëve:

- Niveli kombëtar
- Niveli ndërkombëtar
- Të miturit
- Personat e mbrojtur
- Rekreativë

Është e rëndësishme të dini gjithnjë në cilin grup jeni. Organizata juaj Kombëtare Anti-Doping (NADO) dhe Federata Ndërkombëtare (IF) do të kenë përkufizime specifike për secilin nga këto grupe atletësh.





# Çfarë ndryshimesh janë bërë në arsyetimin e Kodit?

## Shëndeti

- Shëndeti tani është qëllimi kryesor i Kodit Botëror Anti-Doping (Kodi).

## Të drejtat tuaja - Deklarata e të Drejtave Anti-Doping të Atletëve (Deklarata e Atletëve)

- Qëllimi kryesor i Kodit përfshin të drejtat e atletëve.
- Këto të drejta gjenden në nene të ndryshme në të gjithë Kodin. Deklarata e Atletëve i përmbledh këto në një vend.
- Deklarata e Atletëve u zhvillua nga Komiteti i Atletëve të WADA-s në konsultim me Atletët dhe aktorët e tjerë në të gjithë botën dhe synon të shpjegojë qartë të drejtat tuaja anti-doping dhe t'i bëjë ato më të arritshme.
- Deklarata e Atletëve gjithashtu thekson atë që duhet të bëjë komuniteti anti-doping për të mbrojtur të drejtat tuaja.
- Deklarata e Atletëve ka dy pjesë:
  - Pjesa 1 - të drejtat tuaja që gjenden në Kod dhe Standardet Ndërkombëtare
  - Pjesa 2 - të drejtat e rekomanduara të atletëve, që nuk gjenden në Kod dhe në Standardet Ndërkombëtare, por janë të drejta që atletët besojnë se Organizatat Anti-Doping (ADO) duhet të miratojnë si praktikën më të mirë.

- Deklarata e re e Atletëve mund të gjendet brenda Kodit 2021 dhe si një dokument i veçantë (<https://www.wada-ama.org/en/resources/anti-doping-community/athletes-anti-doping-rights-act>).











# Rolet dhe përgjegjësitë tuaja në Kodin 2021

Kodi përshkruan rolin dhe përgjegjësitë  
tuaja lidhur me luftën kundër dopingut.

# Ju rikujtojmë:

## Përgjegjësitë

Të njohësh dhe të respektosh të gjitha politikat dhe rregullat e zbatueshme anti-doping.

**i** Të jesh në dispozicion për testim.

Të marrësh përgjegjësi për ato që merr dhe përdor.

**i** Përgjegjësia rigoroze: Trupi juaj, përgjegjësia juaj.

Të informoni personelin mjekësor për detyrimin tuaj për të mos përdorur substanca të ndaluara dhe metoda të ndaluara dhe marrjen e përgjegjësisë për të siguruar që çdo trajtim mjekësor nuk shkel politikat dhe rregullat anti-doping.

**i** Tregojuni mjekëve dhe infermierëve që ju jeni një atlet dhe nuk mundeni të përdorni substanca dhe / ose metoda të ndaluara. Kontrolloni të gjitha medikamentet që nuk përmbajnë substancë të ndaluar para se t'i merrni. Kërkoni ndihmë nëse nuk jeni të sigurt.

Ndihmoni në një hetim anti-doping sipas kërkesës.

**i** Bashkëpunoni me Organizatat Anti-Doping (ADO) që hetojnë ADRV-të.

## Roli

Të njohësh dhe të respektosh të gjitha politikat dhe rregullat e zbatueshme anti-doping.

**i** Të njohësh rregullat anti-doping dhe t'i respektosh ato!

Bëni të ditur për Organizatën tuaj Kombëtare Anti-Doping (NADO) dhe Federatën Ndërkombëtare (IF) çdo vendim të marrë nga një Organizatë Anti-Doping (ADO) që nuk është një Nënshkrues i Kodit në lidhje me kryerjen e një shkelje të rregullit anti-doping (ADRV) brenda dhjetë viteve të mëparshme.

**i** Tregoni NADO-s tuaj ose Federatës Ndërkombëtare (IF) nëse keni kryer një ADRV në 10 vitet e fundit.

Tregoni identitetin e personelit tuaj mbështetës të atletit tek çdo ADO me autoritet mbi ju që kërkon këtë informacion.

**i** Jepni informacion për ata që ju mbështesin (trajner, fizioterapist, mjek) nëse kërkohet.



# Përkufizimet: Cilat janë risitë në Kodin 2021?

Termet anti-doping përfshihen në seksionin 'Përkufizime' të Kodit Botëror Anti-Doping (Kodi), për të ndihmuar të gjithë të kuptojnë se çfarë nënkuptojnë termet kryesorë. Përkufizimet e mëposhtme janë ndryshuar, shtuar ose sqaruar në Kodin 2021.

## Edukimi

- Kodi 2021 tani përcakton edukimin si **'procesin e tëmësuarit për të ngulitur vlera dhe për të zhvilluar sjelljeqë nxisin dhe mbrojnë frymën e sportit dhe për tëparandaluar dopingun e qëllimshëm dhe tëpaqëllimshëm'**

## Manipulimi

- Manipulimi ka qenë tashmë një Shkelje e Rregullave Anti-doping (ADRV).
- Në Kodin 2021, manipulimi në procesin e testimit ose ndonjë pjesë tjetër të kontrollit doping është dhënë tani si një shembull i qartë i manipulimit.
- Sigurimi i dokumenteve të rreme ose paraqitja e dëshmimeve të rreme nga dëshmitarët tek një Organizatë Anti-Doping (ADO) gjithashtu konsiderohet si manipulim.

## Qëllimi

- Në disa raste, kur një atlet kryen një ADRV, vërtetimi i mungesës së qëllimit është i rëndësishëm për uljen e masës së sanksionit.
- Për këto arsye, 'i qëllimshëm' do të thotë që personi angazhohet në një sjellje të cilën ai ose ajo e dinte që ishte një ADRV ose e dinte që ekzistonte një rrezik domethënës dhe nuk e përfilli atë rrezik.

## Në garë

- Disa substanca dhe metoda janë të ndaluara në çdo kohë, të tjerat janë të ndaluara vetëm në garë. Atletët duhet të dinë se kur është periudha në garë.
- Periudha 'në garë' fillon në orën 23:59 në ditën para garës dhe zgjat deri në fund të garës dhe kur të ketë përfunduar procesi i mbledhjes së mostrës për atë aktivitet.
- Federatat Ndërkombëtare (IF) mund të aplikojnë në Agjencinë Botërore Anti-Doping (WADA) për të ndryshuar periudhën në Garë për një arsye specifike.
- Nëse miratohet, kjo periudhë e veçantë dhe specifike sportive në Garë do të pasohet gjithashtu nga Organizata e Aktiviteteve Madhore (MEO) që organizon gara që përfshijnë këtë sport.

Para çdo gare:



- Të lexoni rregullat anti-doping të Federatës Ndërkombëtare (IF)
- Të kontrolloni periudhën në Garë.

# Cilat janë risitë për edukimin?

- Kodi Botëror Anti-Doping (Kodi) përshkruan se cilët Organizata Anti-Doping (ADO) kanë nevojë ose duhet të edukojnë dhe për çfarë temash.
- Ka qenë e detyrueshme për ADO-t që të sigurojnë edukimin anti-doping që nga Kodi 2015, por 'edukimi' nuk u përfshi në listën e termave të përcaktuara.
- Standardi Ndërkombëtar për Edukimin (ISE) është një Standard i ri Ndërkombëtar që hyn në fuqi në 1 janar 2021.
- Standardi Ndërkombëtar për Edukimin (ISE) ofron detaje se si ADO-t duhet të planifikojnë, ofrojnë, monitorojnë dhe vlerësojnë programet e edukimit anti-doping për ju dhe personelin tuaj mbështetës.
- Standardi Ndërkombëtar për Edukimin (ISE) thekson gjithashtu se është e rëndësishme që ADO-t t'ju edukojnë para se të testoheni.

## INFORMOHUNI!



*Kodi e bën të detyrueshme për ADO-t që të ofrojnë programe edukimi. Varet nga ju gjithashtu që të kërkonit informacionin e nevojshëm për t'u siguruar që po stërviteni dhe konkurroni në përputhje me vlerat e sportit të pastër dhe rregullat anti-doping.*





## Çfarë është e rëndësishme për atletët e tërhequr që rikthehen në garë?

- Nëse ju jeni një atlet i tërhequr që ishit pjesë e Listës së Regjistruar për Testim (RTP) dhe ju dëshironi të riktheheni në konkurrim, ju nuk mund të konkurroni në një aktivitet ndërkombëtar ose kombëtar për aq kohë sa ju nuk jeni i disponueshëm për testim.
- Ju duhet të njoftoni me shkrim gjashtë muaj para Federatën Ndërkombëtare (IF) dhe Organizatën Kombëtare Anti-Doping (NADO). Kjo vlen edhe nëse është një sport i ri / i ndryshëm nga sporti që konkurroni.
- Nëse IF dhe NADO mund të kërkojnë që atletët jo pjesë e RTP-së të dërgojnë një njoftim para se të rikthehen në garë. Është e rëndësishme të informoheni pranë Organizatës tuaj Anti-Doping (ADO) para se të konkurroni.
- Nëse konkurroni në një aktivitet ndërkombëtar ose kombëtar pa dhënë njoftimin gjashtë-mujor, rezultatet tuaja mund të skualifikohen.
- Siç ishte tashmë rasti në Kodin e mëparshëm Botëror Anti-Doping (Kodi), Agjencia Botërore Anti-Doping (WADA), Federata ndërkombëtare (IF) ose NADO përkatëse, mund të japin një përjashtim për njoftimin me shkrim gjashtë-mujor në rrethana të jashtëzakonshme nëse zbatimi i rreptë i këtij rregulli do të ishte i padrejtë për atletin.

### *Ju doni të riktheheni në konkurrim?*

**Dërgoni email** në IF dhe NADO-n tuaj për t'i njoftuar.

*Prisni përgjigjen që konfirmon se ata kanë marrë email-in tuaj dhe ndiqni udhëzimet e tyre para se të konkurroni përsëri.*





# Çfarë ndryshimesh janë bërë në grupet specifike të atletëve?

## 'Personat e mbrojtur' dhe të miturit

- Një 'Person i Mbrojtur' është një atlet
  - nën moshën 16 vjeç; ose
  - nën 18 vjeç dhe nuk është përfshirë në një RTP dhe nuk ka konkurruar kurrë në ndonjë aktivitet ndërkombëtar; ose,
  - të cilët, për arsye të tjera përveç moshës, është përcaktuar se nuk kanë zotësinë juridike sipas legjislacionit të tyre kombëtar.
  - Një Person i Mbrojtur nuk është një atlet i elitës në moshën 16 ose 17 vjeç.
- Një Person i Mbrojtur që kryen një shkelje të rregullave anti-doping (ADRV) mund të përfitojë nga rregullat më fleksibël të sanksioneve.
- Një 'imitur' është një atlet i cili është 17 vjeç ose më i ri.
- Si të mitur, çdo atlet elitë 16 dhe 17 vjeç që ka kryer një ADRV mund të përjashtohet nga deklarimi publik i sanksionit.



Zotësia juridike nënkupton që një person njihet nga ligjet në vendin e tyre dhe se ata mund të përfaqësojnë plotësisht veten lidhur me çështjet siç janë: të marrin vendime për jetën e tyre, të zbatojnë të drejtat e tyre, të lidhin kontrata, të flasën në emër të tyre.

## 'Atletët Rekreativë' - Më shumë fleksibilitet në pasojat e aplikuara

- 'Atletë rekreativë' 'atletët' janë një kategori e re e atletëve në Kodin Botëror Anti-Doping (Kodi) 2021.
- Atletët rekreativë që kryejnë një shkelje të rregullit anti-doping (ADRV) mund të përfitojnë të njëjtin fleksibilitet për sanksionet si Personat e Mbrojtur.
- I takon çdo Organizatë Kombëtare Anti-Doping (NADO) të përcaktojë se kush do të konsiderohej një atlet rekreativ, megjithatë, kjo nuk mund të përfshijë asnjë atlet i cili, në pesë vitet e mëparshme para kryerjes së një ADRV :
  - Ka qenë një atlet i nivelit ndërkombëtar ose i nivelit kombëtar;
  - Ka përfaqësuar vendin në një aktivitet ndërkombëtar në një kategori të hapur; ose
  - Ka qenë pjesë e një Liste të Regjistruar për Testim (RTP) ose në një Listë tjetër Vendndodhjes të administruar nga një Federatë Ndërkombëtare (IF) ose NADO.



Informacionet e vendndodhjes jepen nga disa atletë për të mbështetur testimin jashtë gare. Informacioni që mund të duhet të sigurohet përfshin; adresa brenda natës, periudhën kohore 60 minutëshe çdo ditë të vitit, detajet e kontaktit dhe aktivitetet e rregullta të tilla si trajnimi, puna, shkolla / universiteti.

# Çfarë ka ndryshuar tek substancat dhe si zbulohen ato?

## Të specifikuara dhe jo të specifikuara

- Substancat në Listën e Ndaluar (Lista) klasifikohen si 'të specifikuara' ose 'jo të specifikuara'.
- Substancat e specifikuara ka më shumë të ngjarë të kenë një arsye për tu shfaqur në mostrën e një atleti pasi këto substanca të ndaluara mund të gjenden tek medikamentet lehtësisht të disponueshme.
- Grupi i Ekspertëve të Listës së WADA-s mund të vendosë të klasifikojë disa metoda të ndaluara të specifikuara, ndërsa ishte e pamundur më parë.

## Substancat Abuzive

- Disa substanca të ndaluara janë identifikuar si 'Substanca Abuzive' nga Grupi i Ekspertëve të Listës së WADA-s.
- Nëse një atlet mund të provojë se e ka përdorur substancën jashtë gare dhe se nuk ka lidhje me performancën sportive, mund të zbatohet një sanksion tremujor.
- Sanksioni mund të reduktohet në një muaj nëse atleti përfundon një program rehabilitimi të miratuar nga Organizata Anti-Doping (ADO).

**Lista** përditësohet çdo vit.

Lista e re është botuar në faqen e internetit të WADA ([wada-ama.org](http://wada-ama.org)) në tetor dhe do të hyjë në fuqi nga 1 Janari i vitit pasues.

i

Është e mundur të bëhen ndryshime në Listë më shumë se një herë në vit, por ADO do të ketë 3 muaj kohë për të komunikuar këto ndryshime përpara se ato të hyjnë në fuqi.



## Substancat e shtuara ose të hequra nga Lista

- Kur substancat shtohen ose hiqen nga Lista, ato nuk mund të analizohen, përveç nëse thuhet specifikisht ndryshe, në mostrën e një atleti që është mbledhur tashmë.
- Një atlet që aktualisht ndodhet në një periudhë të papërshtatshmërisë (ndalim për pjesëmarrje në sport) për një substancë që është hequr nga Lista, mund të paraqesë kërkesë tek Autoriteti përkatës i Menaxhimit të Rezultateve (RMA) për të kërkuar një ulje të periudhës së papërshtatshmërisë.



Autoriteti i Menaxhimit të Rezultateve (RMA) është ADO-ja e cila është përgjegjëse për kryerjen e menaxhimit të rezultateve për një çështje.

## Procedurat që lidhen me hapjen e mostrave

- Një mostër mund të ndahet në dy pjesë dhe të përdoret për analizën fillestare. Pjesa e mbetur e mostrës do të ruhet. Kjo do të thotë që mostra B, për shembull, mund të ndahet në dysh dhe të bëhet një mostër e re A dhe B. Të gjithë mostrat e ndara mund të përdoren për të konfirmuar një konstatim fillestar.
- Laboratori dhe / ose ADO me RMA duhet të njoftojnë atletin për mundësinë për të vëzhguar hapjen e shishes së mostrës. Ju gjithashtu keni të drejtë të jeni i pranishëm për ndarjen e mostrës.
- Sidoqoftë, nëse atleti nuk është i pranishëm, mostra mund të hapet, ndahet dhe të analizohet. Hapja mund të bëhet në prani të një dëshmitari të pavarur.



Një Konstatim Analitik Anormal do të thotë se ekziston një substancë e ndaluar në mostrën e atletit dhe kjo raportohet tek një ADO nga një laborator i akredituar nga WADA.

## Mos harroni: Rrezikoheni nga suplementet dhe produktet e tjera

- Kontaminuesit tek suplementet janë një rrezik për atletët pasi këta përbërës nuk janë të shënuar në etiketë dhe shpesh pa dijeni hyjnë në produktin suplement gjatë procesit të prodhimit.
- Atletët do të duhet të përcaktojnë origjinën e saktë të substancës së ndaluar nëse kanë një Konstatim Analitik Anormal (AAF) që ata besojnë se lidhet me përdorimin e suplementit.



**Mos harroni**, gjithmonë duhet të vlerësoni rrezikun përpara se të vendosni të përdorni një suplement dhe të hulumtoni ndonjë produkt para se ta përdorni. Mos marrja seriozisht e këtij rreziku dhe mos bërja e përpjekjeve për të **minimizuar rrezikun** mund të thotë që ju nuk do të përfitoni një sanksion të reduktuar nëse jeni pozitiv, sepse suplementi që keni përdorur ishte i kontaminuar.



# Çfarë ka ndryshuar në mënyrën se si mund të përdoren të dhënat dhe mostrat?

## Përdorimi i informacionit nga analiza e mostrës

- Mostrat mund të përdoren për të verifikuar dhe përmirësuar cilësinë e metodave të zbulimit, për të zhvilluar metoda të reja ose për të ndihmuar në vendosjen e pragjeve (për raportimin e substancave të ndaluara që gjenden në mostra). Me pëlqimin tuaj, mostrat mund të përdoren gjithashtu për kërkime anti-doping.
- Të dhëna nga analizimi i mostrave dhe informacione të tjera anti-doping mund të përdoren gjithashtu për këto qëllime.
- Por, përpara se të përdoren mostrat ose të dhënat për këto qëllime, laboratorët dhe Organizatat Anti-Doping (ADO) duhet të marrin masa në mënyrë që askush të mos ketë dijeni se kujt i përket një mostër ose e dhënë. Ato nuk mund të gjurmohen nga asnjë atlet.

## Përdorimi i laboratorëve të tjerë

- Vetëm rezultatet e miratuara nga Agjencia Botërore Anti-Doping (WADA) ose një laborator i njohur nga WADA mund të përdoren për të përcaktuar një Konstatim Analitik Anormal (AAF).
- Sidoqoftë, analiza nga laboratorë jo të aprovuar / të njohur nga WADA mund të përdoren për të mbështetur një hetim.

## E drejta e WADA-s për të marrë në zotërim

- WADA mund të marrë zotërim të menjëhershëm të mostrave dhe të dhënave anti-doping nga një laborator ose ADO-ja.

## Rregullat Mjekësore, të Sigurisë, Përshtatshmërisë, dhe Kodit të Sjelljes

- ADO-t tuaja ndoshta kanë vendosur mjekësore, të sigurisë, përshtatshmërisë, ose të Kodit të Sjelljes për t'ju mbajtur juve të sigurt dhe sportin e drejtë.

- Kodi Botëror Anti-Doping (Kodi) nuk ndalon Nënshkruesit e tij të kenë këto lloj rregullash që përdoren për qëllime të tjera përveç anti-dopingut për t'ju mbrojtur.
- Aty ku është e nevojshme dhe për të shmangur nevojën e mbledhjes së mostrave shtesë nga atletët, ADO-t mund të përdorin mostra të kontrollit doping dhe të dhëna nga analizat e këtyre mostrave për të zbatuar këto rregulla.



*Sigurohuni që të jeni plotësisht të vetëdijshëm për të gjitha rregullat dhe kodet e sjelljes që duhet të respektoni për të marrë pjesë në mënyrë të sigurt dhe të drejtë në sportin tuaj.*

## Analizë e mëtejshme e mostrave

- Një mostër mund të analizohet shumë herë para se një atlet të njoftohet për një shkelje të mundshme.
- Nëse mostra është negative, ADO që nisi testimin ose WADA mund ta ruajë mostrën në mënyrë të sigurt dhe të bëjë analiza të mëtejshme.
- Çdo ADO me autoritet mbi ju mund të analizojë më tej një mostër negative por ato duhet të marrin leje nga ADO që nisi testimin ose nga WADA.



*Për shembull, Komiteti Ndërkombëtar Paralimpik (IPC) mund të ruajë mostrat e mbledhura gjatë Lojërave Paralimpike dhe më pas t'i ruajë mostrat pasi të jenë përfunduar analizat fillestare. Një NADO mund të kërkojë leje nga IPC për të kryer analiza të mëtejshme mbi mostrën e ruajtur.*

## Çfarë ka ndryshuar me mënyrën se si menaxhohen rezultatet?

- Standardi Ndërkombëtar për Menaxhimin e Rezultateve (ISRM) është një Standard i ri Ndërkombëtar që hyn në fuqi në 1 janar 2021.
- Standardi Ndërkombëtar për Menaxhimin e Rezultateve (ISRM) rendit të gjithë hapat që do të ndiqen nga një Organizatë Anti-Doping (ADO) me Autoritetin e Menaxhimit të Rezultateve (RMA) në lidhje me një shkellje të mundshme të Rregullave Anti-Doping (ADRV). Ai gjithashtu rendit se çfarë informacioni duhet t'i sigurohet atletit dhe në cilën pikë gjatë gjithë procesit.
- Çdo pasojë e imponuar nga një ADO mbi një atlet që ka kryer një ADRV do të njihet nga të gjithë ADO-t e tjera që janë nënshkruese të Kodit Botëror Anti-Doping (Kodi).
- Kjo do të thotë që nëse një atlet pezullohet për kohësisht nga një Federatë Ndërkombëtare (IF) ose Organizatë Kombëtare Anti-Doping (NADO), të gjitha organizatat e tjera do ta mbështesin këtë pezullim.
- Gjërat janë pak më ndryshe gjatë një aktiviteti madhor. Një Organizatë e Aktiviteve Madhore (MEO) mund të përcaktojë një ADRV dhe të vendosë sanksione që lidhen me atë aktivitet (p.sh. anulimi i rezultateve, heqja e akreditimit, pezullimi i përkohshëm), megjithatë menaxhimi i rezultateve dhe vendosja e sanksioneve mund të kryhet nga Federata Ndërkombëtare (IF) përkatëse.



*Për shembull, nëse një sprinter, i cili gjithashtu garon në bobsled, çdo pezullim i përkohshëm do të zbatohet për të dy sportet.*



# Çfarë ndryshimesh janë bërë në shkeljet e rregullave anti-doping (ADRV) dhe sanksionet?

---

## Çfarë është Doping?

Dopingu përcaktohet si ndodhja e një ose më shumë shkeljeve të rregullave anti-doping të përshtatura në Kod. Këto janë:

---

Prania e një substance të ndaluar, metabolitëve të saj ose shënjesve në mostrën e një atleti.

*Testi pozitiv.*

---

Përdorimi ose tentativa e përdorimit nga një atlet i një substance ose metode të ndaluar. Kjo përfshin rastet e Pasaportës Biologjike të Athletit (ABP).

*Përdorimi ose përpjekja për të përdorur një substancë të ndaluar.*

---

Shmangia, refuzimi ose dështimi për t'iu nënshtruar mbledhjes së mostrës së një atleti.

*Mos paraqitja në stacionin e kontrollit doping kur merrni njoftim ose refuzimi i kryerjes së testimit ose dhënies së mostrës së plotë.*

---

Dështimet në lidhje me Vendndodhjet nga një atlet.

*Atletët që nuk janë aty ku ata thonë se do të jenë ose humbasin një test gjatë afatit kohor prej 60 minutave të deklaruar prej tyre, që nuk aplikojnë vendndodhjen e tyre në kohë, ose kanë aplikuar informacione jo të plota ose të gabuara.*

---

---

Manipulimi ose tentativa për manipulim me ndonjë pjese të kontrollit doping nga një atlet ose person tjetër.

*Ndërhyrja në procesin e testimit ose procesit të kontrollit doping, përfshirë gjatë ndjekjes penale të një çështjeje.*

---

Zotërimi i një substance ose metode të ndaluar nga një atlet ose person mbështetës i atletit.

*Duke pasur një substancë të ndaluar në posedimin tuaj.*

---

Trafikimi ose trafikimi i mbetur në tentativa të çdo substance ose metode të ndaluar nga një atlet ose person tjetër.

*Trajtimi, transportimi, shitja ose përpjekja për të shitur substanca të ndaluara.*

---

Administrimi ose administrimi në tentativa nga një atlet ose person tjetër për ndonjë atlet të çfarëdo substance ose metode të ndaluar.

*Dhënia ose përpjekja për t'i dhënë një substancë të ndaluar një atleti.*

---

Bashkëfajësia ose përpjekje për bashkëfajësi nga një atlet ose person tjetër.

*Ndihma ose përpjekja për të ndihmuar në mbulimin e një ADRV-je.*

---

Shoqërimi i ndaluar nga një atlet ose person tjetër.

*Duke punuar ose duke kërkuar ndihmë / shërbime nga dikush që po kryen një periudhë të papërshtatshmërisë.*

---

Veprim nga një atlet ose person tjetër për të dekurajuar ose hakmarrë kundër raportimit tek autoritetet - E RE!

*Veprime që trembin dikë nga raportimi i dyshuar i dopingut, ose veprime hakmarrjeje ndaj atyre që kanë raportuar.*

---



# Ndryshimet

## Bashkëfajësia

- 'Tentativa' u shtua në Shkeljen e Rregullave Anti-Doping për bashkëfajësinë.
- Bashkëfajësia ADRV tani është - ' Asistimi, inkurajimi, ndihma, mbështetja, komplotimi, mbulimi ose çdo lloj tjetër i bashkëfajësisë me dashje që përfshin një ADRV ose një tentativë ADRV konsiderohet një ADRV '.
- Sanksionet mund të shkojnë nga dy vjet deri në një ndalim të përjetshëm.

## Marëdhënia e ndaluar

- Ju nuk keni të drejtë të shoqëroheni ose të punoni me ndonjë personel mbështetës të atletit që ndodhet në periudhën e papërshtatshmërisë.
- Duke vepruar kështu është një Shkelje e Rregullave Anti-Doping (ADRV) - Marrëdhënia e Ndaluar.
- Organizatat Anti-Doping (ADO) duhet të vënë në dispozicion një listë të çdo Personeli të Mbështetjes së Atletit të pezulluar. Ato nuk janë të detyruara t'ju informojnë paraprakisht që një person është pezulluar. Për një rast të Marëdhënies së Ndaluar, ADO duhet të vërtetojë vetëm që atleti e dinte që personi ishte pezulluar.

## Mbrojtja për individët që raportojnë shkeljet

- Dekurajimi i dikujt nga raportimi i informacionit në lidhje me aktivitetet e dopingut (përfshirë mosrespektimin e Kodit) është një ADRV e re.

- Hakmarrja ndaj një personi tjetër për raportimin e informacionit në lidhje me aktivitetet e dopingut përbën një ADRV të re.
  - Sanksionet mund të shkojnë nga dy vjet deri në një ndalim të përjetshëm.



*Kallzimi është një pjesë thelbësore e ruajtjes së sportit të pastër. Atletët duhet të inkurajohen që të raportojnë çdo dyshim të sjelljes doping tek ADO-t përkatëse.*

*Platforma e WADA-s SpeakUp (Fol Hapur) ju lejon ta bëni këtë në mënyrë anonime.*

## Fleksibiliteti i sanksioneve në rast refuzimi ose falsifikimi

- Në rrethana të jashtëzakonshme, sanksioni për refuzimin e testimin ose manipulimin në procesin e testimin mund të jetë nga dy deri në katër vjet.

## Manipulimi

- Manipulimi gjatë procesit të menaxhimit të rezultateve konsiderohet si shkelje e parë e veçantë.
- Sanksioni për manipulimin gjatë procesit të menaxhimit të rezultateve është dy deri në katër vjet dhe do t'i shtohet çdo sanksioni ekzistues për shkeljen origjinale.

## Rrethanat rënduese

- Në rastet kur ekzistojnë rrethana të veçanta ose të jashtëzakonshme, mund të zbatohet një sanksion shtesë deri në dy vjet.

## Ndihma thelbësore

- Një sanksion i pezulluar, tani mund të jepet nëse ndihma thelbësore e dhënë ndihmon për të vendosur mosrespektimin e Kodit Botëror Anti-Doping (Kodi) dhe / ose Standardeve Ndërkombëtare ose ndihmon për të zbuluar lloje të tjera të shkeljeve të integritetit sportiv.
- Reduktimi i sanksionit varet nga ndihma e dhënë në të vërtetë që ndihmon Organizatën Anti-Doping (ADO). Nëse informacioni i dhënë nuk ndihmon, periudha e papërshtatshmërisë nuk do të reduktohet.
- Agjencia Botërore Anti-Doping (WADA) mund të bie dakord të mos ta deklarojë publikisht një ADRV në këmbim të ndihmës thelbësore.

## Marrëveshjet e Menaxhimit të Rezultateve

- Një atlet ose person tjetër që kryen një Shkelje të Rregullit Anti-Doping (ADRV) dhe po përballë me një sanksion katër-vjeçar mund të reduktohet sanksioni i tyre me një vit nëse pranojnë ADRV-në brenda 20 ditëve nga njoftimi i akuzës.



*Ndihma thelbësore është kur jepet informacion që ndihmon një ADO për t'u angazhuar në raste të tjera kundër individëve ose ndonjë papajtueshmërie të një Nënshkruesi, si shembuj.*

- Një ADO, atlet ose person tjetër dhe WADA mund të hyjnë në një 'Marrëveshje për Zgjidhjen e Çështjes' ku sanksioni i zbatueshëm mund të vendoset bazuar në faktet e çështjes.
- Marrëveshjet për zgjidhjen e çështjes nuk mund të ankimohen.
- Një atlet që po negocion një Marrëveshje për Zgjidhjen e Çështjes ka të drejtë ta tregoj historinë e tij në kuadër të një "Marrëveshje pa Paragjykime".



*Njoftimi i akuzës është komunikimi zyrtar i marrë nga ADO që tregon se ka ndodhur një ADRV.*



*Marrëveshja pa paragjykime do të thotë se çdo gjë e rënë dakord nuk mund të përdoret më vonë në një proces dëgjimi përveç nëse ka një marrëveshje nga të dy palët atletët dhe ADO.*

## Përmirësimet për Shkeljet e Shumta të Rregullave

- Si përcaktohet periudha e papërshtatshmërisë për një ADRV të dytë është ndryshuar për të qenë më proporcionale dhe jo aq e varur nga rendi në të cilin ndodhën dy shkeljet.



*Për shembull, si pjesë e një hetimi ose analizës së përsëritur të mostrave të ruajtura, një AAF mund të zbulohet në një mostër që është mbledhur më shumë se 12 muaj para ADRV-së tashmë të zbuluar.*

*Të dy ADRV-të konsiderohen si shkelje e parë.*

*Sanksioni për ADRV-në e zbuluar më vonë do t'i shtohet periudhës ekzistuese të papërshtatshmërisë.*

## Paratë e Çmimit të Humbur

- Nëse një Organizatë Anti-Doping (ADO) mbledh paratë shpërblyese të humbura nga një atlet si rezultat i një ADRV-je, ADO do të marrë masa të arsyeshme për të shpërndarë paratë e çmimit për atletët që do të kishin të drejtë për të.
- Varet nga rregullat e bordit sportiv nëse rishikohet ndonjë renditje e bazuar në paratë e çmimit.

## Sanksionet për Shkeljen e një Pezullimi të Përkohshëm

- Një atlet i cili është pezulluar përkohësisht nga sporti por vazhdon të marrë pjesë gjatë kësaj kohe nuk do t'i jepet asnjë bonus (për kohën tashmë të kryer) për këtë periudhë.
- Atletëve që vazhdojnë të garojnë ndërsa janë pezulluar përkohësisht do t'i anulohen rezultatet e tyre.

## Sanksionet për mosrespektimin e një nënshkruesi dhe ndikimi mbi atletët

- Standardi Ndërkombëtar për Pajtueshmërinë me Kodin nga Nënshkruesit (ISCCS) përshkruan procesin dhe pasojat për Nënshkruesit që nuk janë në përputhje me Kodin Botëror Anti-Doping (Kodi).
- Si mjet i fundit, pasojat për mospërputhje me Kodin mund të përfshijnë moslejimin e atletëve të garojnë në aktivitete ndërkombëtare.





# Cilat janë risitë lidhur me seancën dëgjimore dhe ankimin?

---

- Standarde më rigorozë për seanca të drejta, duke përfshirë kërkesën që panelet e dëgjimit të jenë operacionalisht të pavarura nga Autoriteti i Menaxhimit të Rezultateve (RMA), hetimi dhe çdo vendim për të vazhduar çështjen. Përveç kësaj, organi i ankimit gjithashtu duhet të jetë institucionalisht i pavarur nga RMA.
- I mbetet atletit ose personit tjetër që të vërtetojë se çdo vonesë në procesin e dëgjimit nuk është faji i tyre.
- Çdo palë (organizatë ose individ) që bën një ankim mund të paraqesë prova të reja, argumente ligjore dhe pretendime që nuk ishin paraqitur në seancën fillestare. Çdo provë e re duhet të lidhet me të njëjtën shkak të veprimit ose të njëjtat fakte të përgjithshme ose rrethana të trajtuara në seancën fillestare.
- Kur struktura e organit të apelit të nivelit kombëtar nuk është e drejtë, e paanshme dhe e pavarur nga ana operationale dhe institucionale, atleti ose personi tjetër ka të drejtë të ankohet në Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv (CAS).



## Konkluzion

---

- Ky udhëzues për atletët është një përmbledhje e ndryshimeve më të rëndësishme në Kodin Botëror Anti-Doping (Kodi) 2021 që mund të ketë ndikimin më të madh tek ju dhe atletët e tjerë. Ne gjithashtu kemi përfshirë disa kujtesa të temave kryesore anti-doping për të cilat atletët duhet të jenë gjithmonë të vetëdijshëm.
- Ju mund të mësoni më shumë rreth Kodit 2021 dhe Standardeve Ndërkombëtare përmes platformës së Edukimit Anti-Doping të Agjencisë Botërore Anti-Doping (WADA) (ADEL). Regjistrohuni ose vizitoni tani në <https://adel.wada-ama.org>.
- Ju lutemi shikoni në faqen e internetit të WADA-s (<http://www.wada-ama.org>) për të parë Kodin dhe Standardet Ndërkombëtare.
- Mos harroni të konsultoheni me NADO-n tuaj dhe IF për të kuptuar ndryshimet e bëra në rregullat e tyre anti-doping dhe të konsultoheni me programet dhe materialin edukativ që ata kanë vënë në dispozicion për ju.





WADA's regulatory documents are available on the Agency's website. The material that WADA provides on its ADEL platform is intended for educational and informational purposes only. Any content or language used within the ADEL material would not supersede the provisions of the World Anti-Doping Code and/or the International Standards.

ADEL and its education courses and information resources are managed by WADA and published by WADA in English as a minimum.

This version has been kindly translated by the **National Antidoping Organization of Albania.**

In any case of any discrepancies between the English version or any version sponsored by an Anti-Doping Organization, the English version shall prevail.

#### HEAD OFFICE

800 Place Victoria, Suite 1700  
P.O. Box 120  
Montreal, Quebec, Canada H4Z 1B7  
T +1.514.904.9232  
F +1.514.904.8650

#### AFRICA

Protea Assurance Building  
8th Floor, Greenmarket Square  
Cape Town, 8001, South Africa  
T +27.21.483.9790  
F +27.21.483.9791

#### ASIA / OCEANIA

C/O Japan Institute of Sports Sciences  
3-15-1 Nishigaoka, Kita-Ku  
Tokyo, 115-0056, Japan  
T +81.3.5963.4321  
F +81.3.5963.4320

#### EUROPE

Maison du Sport International  
Avenue de Rhodanie 54  
1007 Lausanne, Switzerland  
T +41.21.343.43.40  
F +41.21.343.43.41

#### LATIN AMERICA

World Trade Center Montevideo  
Tower II, Unit 712  
Calle Luis A de Herrera 1248  
Montevideo, Uruguay  
T +598.2.623.5206  
F +598.2.623.5207

Dokumentet rregulluese të WADA-s janë në dispozicion në faqen e internetit të Agjencisë. Materiali që WADA ofron në platformën e saj ADEL është menduar vetëm për qëllime edukative dhe informuese. Çdo përmbajtje ose gjuhë e përdorur brenda materialit ADEL nuk do të zëvendësojë dispozitat e Kodit Botëror Anti-Doping dhe / ose Standardeve Ndërkombëtare.

ADEL dhe kurset e tij të edukimit dhe burimet e informacionit menaxhohen nga WADA dhe publikohen nga WADA në anglisht minimalisht.

Ky version është përkthyer nën kujdesin e **Organizatës Kombëtare Antidoping të Shqipërisë**

Në çdo rast të ndonjë mospërputhje midis versionit anglisht ose cilitdo version të sponsorizuar nga një Organizatë Anti-Doping, versioni Anglisht do të mbizotërojë.

- [wada-ama.org](http://wada-ama.org)
- [twitter.com/wada\\_ama](https://twitter.com/wada_ama)
- [facebook.com/wada.ama](https://facebook.com/wada.ama)
- [@wada\\_ama](https://www.instagram.com/wada_ama)
- [linkedin.com/company/wada/](https://www.linkedin.com/company/wada/)
- [info@wada-ama.org](mailto:info@wada-ama.org)